

PSH.nr.934/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenkovic - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Agrium”SH.P.K-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kontinjer dhe shporta të mbeturinave” me nr. të prokurimit: 622-20-6592-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Prizren”, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Agrium”SH.P.K-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kontinjer dhe shporta të mbeturinave” me nr. të prokurimit: 622-20-6592-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Prizren.

II. OBLIGOHET, AK “KK-Prizren” ti bëj ndryshimet në dosje të tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysht udhëzimet e dhëna si në këtë vendim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kontinjer dhe shporta të mbeturinave” me nr. të prokurimit: 622-20-6592-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Prizren.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Agrium”SH.P.K-Ferizaj, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Agrium"SH.P.K-Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.11.2020 me nr. 934/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me kontinjer dhe shporta të mbeturinave" me nr. të prokurimit: 622-20-6592-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prizren", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 27, 28 dhe 69.2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18 dhe 20 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues pretendon se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18 të RROUPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit ka vendosur kritere dhe kërkesa diskriminuese dhe në të njëjtën kohë favorizuese për OE të caktuar. Kërkesa 1 Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 1 "Projektet e natyrës së kontratës realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 150.000,00 €" Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: "Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimi përfundimtar të furnizimeve". Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa "Dëshmia 1 Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimi përfundimtar të furnizimeve", është jo shumë e qartë dhe mund

të sqarohet më mirë, e ku në vend të kufizimit me shprehjen “kontrata”, mendoj se duhet të shënohet: Të dëshmuara me referenca apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve të natyrës së kontratës ose të ngjashme”. Në nenin 18.9 të RRUOPP-së, thuhet: “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE-ve, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 3 “Të ketë së paku 4 punëtorë për realizim të kontratës” Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “Lista e të punësuarve e paraqitur ne ATK ne tre muajit e fundit bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës. përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt , për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt” Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa nuk paraqet diskriminim për asnjë OE ndërsa sa i përket nevojës së përcaktimit të kësaj kërkesë nga ana e AK-së, eksperti vlerëson që është kompetencë ligjore e AK-së të përcaktoj kërkesat sipas dispozitave të Nenit 27 të LPP-së dhe RROUP.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 4 “Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton pesha ngarkuese”. Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezë të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë”. Pas analizës së kërkesës me numër rendor 4 eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa aktuale është e definuar jo mire për OE, andaj do të duhej të qartësohet më mire. Si p.sh “Të ketë në pronësi ose në posedim kamion transportues me peshë ngarkuese prej X deri X ton, në mënyrë që të kenë mundësi pjesëmarrje më shumë OE”.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 5 “OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizreni ”. Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë për pikën e shpërndarje së furnizimit ”. Duke pas parasysh që kontrata ka të bëjë me furnizim dhe liferimi për këtë aktivitet të prokurimit mund të bëhet pa pasur nevojë të ketë depo apo pikë në qytetin e Prizrenit apo 5 km larg Prizrenit sepse liferimi mund të bëhet nga secili cep i

Kosovës në një afat kohorë mesatarisht 2 orë. Eksperti shqyrtues mendon se duhet të largohet kjo kërkesë në mënyrë që të krijohen më shumë oferta dhe të mos ketë diskriminim.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon se ka qenë e pa nevojshme dhe nuk do të duhej që AK të kërkojë që OE ti paraqesin mostrat për kontinjer, si dhe përdorimi i markës së caktuar nga AK për OE është diskriminuese dhe favorizon kompani të caktuara. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 6 “OE që ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM “Ekoregjon” ne Prizren –rruga Tahir Sinani nr”. Pas analizës së Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me këtë kërkesë, eksperti shqyrtues sqaron se është e drejtë e AK-së që OE-ve të ju kërkojë që ti prezantojnë mostrat e produkteve dhe kjo nuk paraqet diskriminim, mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se sa u përket emërtimit të prodhuesve të caktuar AK nuk do të duhej që të kërkojë produkt me emër të markës së caktuar të prodhuesit sepse kjo paraqet diskriminim dhe favorizim të ndonjë OE pjesëmarrës. Në nenin 20.4 të RROUP thuhet: Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtim të pretendimeve ankimore të OE ankues analizë konkrete dhe dokumentacion të lëndës, eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues sit të bazuar, duke sugjeruar Autoritetin Kontraktues të bëjë korrigjimet e duhura përkitazi me dispozitat e LPP-së dhe RROUP.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të bëhen ndryshimet e duhura, të njoftohen palët me ndryshimet dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Agrium” SH.P.K -Ferizaj, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar/a, Me këtë letër dhe në emër të OE "AGRIUM SHPK" dua të ju konfirmoj se kemi pranuar ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues me numër 934/20 të datës 27.11.2020 të cilën e PRANOJMË pjesërisht dhe njëherit kërkojmë nga OSHP që para organizimit të seancës të i kërkoj Ekspertit Shqyrtues që ta bëjë edhe njëherë shqyrtimin e disa pretendimeve të ankesës bazuar plotësisht në LPP dhe në faktet e ofruara nga ne. Sipas Ekspertit Shqyrtues ankesa jonë nënkupton se është e pjesërisht e bazuar ku disa trajtime të cilat I ka bërë, është bazuar në pretendimet tona dhe i ka pranuar sit ë bazuar sipas ligjit të LPP, por disa pretendime të cilat do t'i përmendim më poshtë nuk janë të trajtuara siç duhet duke e pasur parasysh rëndësinë e atyre pretendimeve.

Pretendimi 2: Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues të trajtoj përsëri pretendimin 2.: "Dëshmi 3 Lista e të punësuarve e paraqitur ne ATK ne tre muajit e fundit bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës, përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt , për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt." Ne mendojmë se ky kriter është I panevojshëm pasi që ky aktivitet ka të bëjë me furnizim të kontejnerëve, ku për këtë furnizim që zgjat më pak se 1-2 orë nuk ka nevojë që OE të ketë punëtor pasi që për zbrazen e këtij kamioni mund të marr 4 punëtor me pagesë ditore dhe ta bëjë zbrazen apo furnizimin pa problem.


Pretendimi 3:

Trajtimin e pretendimit që ka bërë Eksperti nuk është I qartë dhe nuk ka bërë ekspertizë të detajuar. Në bazë të ligjit të LPP-së dhe RROUP shumë qartë e kërkojnë që: "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik". AK ka vendosur në specifikimet teknike dimensione fiksuese të cilat automatikisht favorizojnë një OE të caktuar. Pasi kompania jonë ka vërejtur në specifikimet teknike ato dimensione, dhe pasi që ne si kompani njohim pothuajse të gjithë prodhuesit e kontejnerëve të Evropës, ne kemi hulumtuar dhe kemi gjetur se ato specifikime teknike të produktit 2 dhe 3 të paramasës, janë të prodhuesve që I kemi cekur në ankesë ku dhe kemi treguar screenshot në ëebfaqet e tyre që janë IDENTIKE: Kontejner Plastik 1100L - janë të prodhuesit EUROPLAST – Austri Kontejner Plastik 120L – janë të prodhuesit – PLASTIK GOGIC - Serbi


NUK MUND TË GJINDEN ASKUND PRODUKTE ME DIMENSIONE TË TILLA NGA ASNJË PRODHUES NË BOTË, PËRPOS KËTO DY KOMPANI.

Secili prodhues I produkteve të kontejnerëve plastik dhe metalik prodhojnë në bazë të kallapit (Klisheve), ku secili prodhues në botë ka klishe të ndryshme dhe njëkohësisht të veçantë. Specifikat teknike duhet më shumë të bazohen në standardin EN 840, ku ky standard përcakton dimensionet e produkteve të kontejnerëve sipas direktivave të Bashkimit Evropian (EU), dhe jo dimensioneve të fiksuara. AK duhet të ketë parasysh

këtë pike dhe duhet të bazohet nga AK të tjerë se si I kanë vendosur specifikimet teknike për kontejner, ja ilustrimi më poshtë: AK – KK. DEÇAN, Nr. Prokurimit: 631-20-6252-1-2-1



Shihet qartë si AK nuk ka vendosur kritere (dimensione diskriminuese) ku ka vendosur me dimensionin P.sh Lartësia: 555 mm MAX. AK me këtë dimension thotë se kontejneri ka të drejtë të jetë maksimum 555mm I lartë. AK – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Nr. Prokurimit: 210-20-6838-1-1-1



Shihet qartë si AK nuk ka vendosur kritere (dimensione diskriminuese) ku ka vendosur me dimensionin P.sh Lartësia: 555 mm MAX. AK me këtë dimension thotë se kontejneri ka të drejtë të jetë maksimum 555mm I lartë. Kërkojmë nga Eksperti të bëjë rishqyrtim të trajtimit të Ankesës dhe posaçërisht të Pretendimit 2 dhe 3, dhe ta trajtoj në bazë të rëndësisë pasi nëse nuk hoqën ato dimensione, për ne dhe OE të tjerë që po ashtu janë ankuar në AK, është e pamundur të ofertojmë e sidomos të dërgojmë mostra pasi nuk mund të marrim nga këta 2 prodhues. Ju informojmë që po ashtu kompania jonë ka bërë kërkesë për monitorim nga KRPP për

këtë aktivitet të prokurimit. Bazuar në të gjitha këto që i thamë më lartë, kërkojmë nga Kryetari i OSHP-së, z. Blerim Dina që para se të mbahet seanca e shqyrtimit kryesorë, të kërkoj nga Ekspertin Shqyrtues që edhe njëherë ta trajtoj ankesën tonë duke u bazuar në faktet e ofruara nga ne, në dispozitat e LPP-së, interpretimet e KRPP-së si dhe në vendimin e më hershëm të OSHP-së. Ne mbetemi me shpresë se Paneli Shqyrtues dhe Eksperti shqyrtues do të veprojnë drejt për parandalimin e kësaj shkelje të AK-së, dhe gjatë trajtimit të lëndës në seancën kryesore do të shoshit argumentet dhe faktet e dorëzuara nga ne dhe pretendimet tona do të aprovoj si të bazuara. Nisur nga kjo kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lëndën kthej në rivlerësim.

Sinqerisht, AGRIMUM SH.P.K.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Agrium”SH.P.K-Ferizaj, se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18 të RROUPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit ka vendosur kritere dhe kërkesa diskriminuese dhe në të njëjtën kohë favorizuese për OE te caktuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 1 “Projektet e natyrës së kontratës realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 150.000,00 €” Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimi përfundimtar të furnizimeve”.

Për këtë kërkesë të AK-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa “Dëshmia 1 Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimi përfundimtar të furnizimeve”, është jo shumë e qartë dhe mund të sqarohet më mirë, e ku në vend të kufizimit me shprehjen “kontrata”, autoriteti kontraktues duhet të kërkoj: “Të dëshmuara me referenca apo proces verbal të pranimi përfundimtar të punëve të natyrës së kontratës ose të ngjashme”. Në nenin 18.9 të RRUOPP-së, thuhet: “Dosja e tenderit do të përgatitet në

mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE-ve, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.

Në pretendimin tjetër të OE ankues se kërkesa 3 në dosje të tenderit është e panevojshme, ku AK tek kjo kërkesë ka kërkuar: Kërkesa 3 “Të ketë së paku 4 punëtorë për realizim të kontratës” Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashkë me përshkrimin e shkurtër të vendit të punës, përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt”. Më tej, OE ankues shton se ky kriter është i panevojshëm pasi që ky aktivitet ka të bëjë me furnizim të kontejnerëve, ku për këtë furnizim që zgjat më pak se 1-2 orë nuk ka nevojë që OE të ketë punëtor pasi që për zbrazjen e këtij kamioni mund të marr 4 punëtor me pagesë ditore dhe ta bëjë zbrazjen apo furnizimin pa problem.

Paneli Shqyrtues sqaron se përderisa AK e ka lënë të hapur mundësinë që operatorët ekonomik munden pëe stafin e ri kontratat e bashkëpunimi dhe po ashtu OE e pranon që me 4 punëtor me pagesë ditore mund ta bëjë zbrazjen apo furnizimin pa problem, atëherë Paneli Shqyrtues konsideron se OE duhet të plotësoj anën formale me 4 punëtor duke bërë marrëveshje dhe të evidentohen këta punëtor, që në mënyrë indirekte arrihet edhe mbrojtja e punëtorëve e paraparë edhe me RRUOPP. Për më tepër, Paneli Shqyrtues konsideron se kjo kërkesë nuk paraqet diskriminim për asnjë OE ndërsa sa i përket nevojës së përcaktimit të kësaj kërkesë nga ana e AK-së, Paneli Shqyrtues vlerëson se është kompetencë ligjore e AK-së të përcaktoj kërkesat sipas dispozitave të Nenit 27 të LPP-së dhe RROUP.

Në pretendimin e tretë të OE ankues në ankesë, si dhe në shkresën drejtuar OSHP-së, pretendon se në bazë të të LPP-së dhe RROUP, shumë qartë e kërkojnë që: “Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik”. AK ka vendosur në specifikimet teknike dimensione fiksuese të cilat automatikisht favorizojnë një OE të caktuar. Pasi kompania jonë ka vërejtur në specifikimet teknike ato dimensione, dhe pasi që ne si kompani njohim pothuajse të gjithë prodhuesit e kontejnerëve të Evropës, ne kemi hulumtuar dhe kemi gjetur se ato specifikime teknike të produktit 2 dhe 3 të paramasës, janë të prodhuesve që I kemi cekur në ankesë ku dhe kemi treguar screenshot në ëbfaqet e tyre që janë INDENTIKE: Kontejner Plastik 1100L - janë të prodhuesit EUROPLAST – Austri Kontejner Plastik 120L – janë të prodhuesit – PLASTIK GOGIC – Serbi. Nuk mund të gjinden askund produkte me dimensione të tilla nga asnjë prodhues në botë, përpos këto dy kompani. Secili prodhues I produkteve të kontejnerëve plastik dhe metalik prodhojnë në bazë të kallapit (Klisheve), ku secili prodhues në botë ka klishe të ndryshme dhe njëkohësisht të veçantë. Specifikat teknike duhet më shumë të bazohen në standardin EN 840, ku ky standard përcakton dimensionet e produkteve të kontejnerëve sipas direktivave të Bashkimit Evropian (EU), dhe jo dimensioneve të fiksuara.

AK duhet të ketë parasysh këtë pike dhe duhet të bazohet nga AK të tjerë se si I kanë vendosur specifikimet teknike për kontejner, ja ilustrimi më poshtë: AK – KK. DEÇAN, Nr. Prokurimit: 631-20-6252-1-2-1. Shihet qartë si AK nuk ka vendosur kritere (dimensione diskriminuese) ku ka vendosur me dimensionin P.sh Lartësia:555 mm MAX. AK me këtë dimension thotë se kontejneri ka të drejtë të jetë maksimum 555mm I Lartë. AK – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Nr. Prokurimit: 210-20-6838-1-1-1.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimit ankimor, konsideron se ky kriter është kufizues i cili paraqet diskriminim apo favorizim. Andaj, duke u bazuar në nenin 9 të RRUOPP-së, AK duhet që të kërkoj nga njësia e kërkesës që ti shqyrtoj parametrat të cilët i konteston OE ankues duke kërkuar nga njësia e kërkesës që të sigurohet që nuk ka kufizime në specifikime (dimensione) në mënyrë që të sigurohet konkurrenca maksimale. Konkretisht, njësia e kërkesës duhet që të përcaktoj pragun minimal (nga x) dhe maksimal (deri në x) të parametrave esencial për AK por gjithmonë duke pasur parasysh rritjen e konkurrencës dhe eliminimin e kriterëve diskriminues apo kufizues për operatorët ekonomik. Kjo kërkesë duhet të merret parasysh edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit në shërbim të nenit 1 dhe 6 të LPP-së, duke pasur synim shfrytëzimin e fondeve publike në mënyrën me ekonomike.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues që ka të bëjë me kërkesën 4 të dosjes së tenderit dhe e njofimit për kontratë, ku AK ka kërkuar: Kërkesa 4 “Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton pesha ngarkuese”. Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezë të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet të dëshmohet me kontratë”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa me numër rendor 4 është e definuar jo mire për OE, andaj AK duhet ta qartësoj më mire. Si p.sh “Të ketë në pronësi ose në posedim kamion transportues me peshë ngarkuese prej X deri X ton, në mënyrë që të kenë mundësi pjesëmarrje më shumë OE”.

Në lidhje me pretendimin e radhës së OE ankues, ku AK ka kërkuar tek Kërkesa 5 “OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet të ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizrenit”. Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: “OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet të na sjell deklaratën e selisë për pikën e shpërndarje së furnizimit”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pas parasysh që kontrata ka të bëjë me furnizim dhe liferimi për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë mund të bëhet pa pasur nevojë të ketë depo apo pikë në qytetin e Prizrenit apo 5 km larg Prizrenit sepse liferimi mund të bëhet nga secili cep i Kosovës në një afat kohorë mesatarisht 2 orë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK duhet të largoj këtë kërkesë në mënyrë që të krijohen më shumë oferta dhe të mos ketë diskriminim.

OE ankues pretendon se ka qenë e pa nevojshme dhe nuk do të duhej që AK të kërkojë që OE ti paraqesin mostrat për kontenjer, si dhe përdorimi i markës së caktuar nga AK për OE është diskriminuese dhe favorizon kompani të caktuara.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 6 “OE qe ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM “Ekoregjion” ne Prizren –rruga Tahir Sinani nr”. Pas analizës së Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me këtë kërkesë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se është e drejtë e AK-së që OE-ve të ju kërkojë që ti prezantojnë mostrat e produkteve dhe kjo nuk paraqet diskriminim. Mirëpo, sa i përket kërkesës që lidhet me prodhues të caktuar, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk duhet që të kërkojë produkt me emër të markës së caktuar të prodhuesit sepse kjo paraqet diskriminim dhe favorizim të ndonjë OE pjesëmarrës. Në nenin 20.4 të RROUP thuhet: Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka caktuar kërkesa diskriminues apo favorizuese për operator ekonomik të caktuar në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti ndryshoj kërkesat për të cilat është dhënë përgjigje nga Paneli Shqyrtues dhe të zgjas afatin për dorëzimin e tenderëve konform dispozitave ligjore.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Prizren”;
- 1x1 OE “Agrium”SH.P.K –Ferizaj;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.